



Botim i Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

**Ne mund të bëjmë zgjedhje...
...PA LËNDUAR të tjerët!**

Broshurë për djemtë dhe burrat

Tiranë, nëntor 2005

Kjo broshurë botohet në kuadrin e projektit “Fushatë ndërgjegjësimi kundër dhunës ndaj gruas”, i financuar nga NWP (Network Women’s Program), New York.

Botimi i kësaj broshure është financuar nga NWP, Kryqi i Kuq Spanjoll dhe Kryqi i Kuq Shqiptar.



Përktheu dhe përshtati: Admir Meko

Ky material është shkëputur nga: <http://www.michaelkaufman.com>

© Michael Kaufman, 2005.

Botuar në shqip nga:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Kutia postare 2418, Tiranë

Tel. & Fax: (355) 4 255514/5

E-mail: info@women-center.tirana.al

Këtë botim mund ta gjeni në formë elektronike në adresën:

<http://www.women-center.org.al>

Design & Layout: Vjollca Ruvina

Shtypur në shqypshkronjën “PEGI”

Tirazhi 2000 kopje

ISBN 99927-974-7-9

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën, kurse të gjithë ne, po! | 5 |
| Çfarë mund të bësh dhe ti për të ndaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave? | 8 |
| Dëgjoji gratë, mëso prej tyre | 8 |
| Informohu rreth problemit | 9 |
| Mëso se përse meshkujt janë kaq të dhunshëm | 9 |
| Vendos një fjongo vjollcë | 11 |
| Kundërshto gjuhën seksiste dhe talljet që i degradojnë gratë | 11 |
| Identifiko dhe kundërshto dhunën | 12 |
| Mbështet programet lokale të grave | 12 |
| Mendo sesi sjellja jote do të kontribuojë në zgjidhjen e problemit | 13 |
| Puno në drejtim të zgjidhjeve afatgjata | 13 |
| Përfshihu në përpjekjet edukative kundër dhunës ndaj gruas | 14 |
| Shtatë karakteristikat e dhunës mashkullore | 15 |
| 1. Pushteti Patriarkal | 16 |
| 2. Meritimi i privilegjit | 17 |
| 3. Pranimi | 17 |
| 4. Paradoksi i pushtetit të burrit | 18 |
| 5. Parzmorja psikike e burrërisë | 20 |
| 6. Shtypja e ndjenjave | 20 |
| 7. Përvojat e kaluara | 22 |
| Dhënia fund e dhunës | 23 |
| Kontakte të nevojshme | 26 |
| Referencat | 28 |



Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën,

kurse të gjithë ne, po!¹

Nëse do të zhvillohej midis shtetesh, do ta quanim luftë. Nëse do të ishte një sëmundje, do ta quanim epidemi. Nëse do të ishte një derdhje e naftës diku në det, do ta quanim një katastrofë. Por, është diçka që po u ndodh grave dhe konsiderohet si një çështje e jetës së përditshme. Është dhuna ndaj grave. Është ngacmimi seksual në punë dhe abuzimi seksual i vajzave të reja. Është rrahja ose dhuna fizike që secila prej miliona grave vuan çdo ditë. Është përdhunimi brenda shtëpisë ose në një takim. Është vrasja.

Nuk është se ka ndonjë armik sekret që tërheq këmbëzën e armës. Nuk ka ndonjë virus të padukshëm që çon në vdekje. Janë vetëm meshkujt. Jo të gjithë meshkujt, por mund të themi shumë prej tyre. Në disa vende shumica e meshkujve kurrë nuk do të jenë të dhunshëm ndaj një gruaje. Ndërsa në vende të tjera, pjesa më e madhe e meshkujve do ta konsiderojnë si një të drejtë që e

fitojnë që në lindje: të bëjnë çfarë të duan dhe kur të duan ndaj grave.

Por cilët janë këta meshkuj? Thjesht meshkuj normalë, që vijnë nga të gjitha shtresat sociale dhe të të gjitha ngjyrave dhe moshave. Të pasur, të varfër që punojnë tokën, apo meshkuj që qëndrojnë në zyrë pas një tavoline. Të gjithë këta janë meshkuj normalë, megjithatë, kanë ndihmuar në krijimin e një klime frike dhe mosbesimi tek gratë. Shumë nga gratë, nënat dhe motrat, të dashurat dhe bashkëshortet tona nuk ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre. Natën ato nuk mund të shkojnë të blejnë diçka për të ngrënë, pa parë se kush po ecën pas tyre. Është e vështirë që ato të ndezin televizorin dhe të mos shohin meshkuj që shfaqin brutalitetin e tyre ndaj femrave dhe meshkujve të tjerë. Megjithëse këto gra kanë marrëdhënie me meshkuj që janë të sjellshëm dhe të ndjeshëm ndaj tyre, ato prapëseprapë nuk mund t'u besojnë plotësisht të gjithë

¹ Ky mesazh ndërkombëtar transmetohet nga Fushata e Fjongove të Bardha: www.whiteribbon.com

meshkujve. Të gjitha femrat ndihen "të burgosura" brenda një kulture të dhunës.

Dhuna e meshkujve ndaj femrave nuk është një sjellje normale. Meshkujt kanë krijuar kultura ku përdorin dhunën edhe ndaj meshkujve të tjerë, ku ne shfryjmë dhunën në habitatin natyror, ku ne shohim dhunën si mjetin më të mirë për të zgjidhur dallimet me kombeve, ku çdo djalë detyrohet dhe nxitet që të luftojë dhe ku meshkujt kanë forma të pushtetit dhe të privilegjit që femrat nuk mund t'i shijojnë.

Meshkujt janë përcaktuar si pjesë e problemit. Por, kjo fushatë beson se meshkujt munden dhe duhet të jenë pjesë e zgjidhjes së problemit. Përballimi i dhunës së meshkujve nuk kërkon asgjë më shumë sesa një angazhim për t'u dhënë drejtësi grave, si dhe një ridimensionim të asaj se çfarë do të thotë të jesh mashkull, duke zbuluar kuptimin e mashkulloritetit, për të cilin nuk ka nevojë që të derdhet gjak.

Me të gjithë dashurinë, respektin dhe mbështetjen për gratë e pranishme në jetën tonë:

- Ne nxisim të gjithë meshkujt në vendin tonë të vendosin në bluzë një fjongo vjollcë ose ta varin atë në shtëpitë e tyre, në makina ose në vendin e punës, çdo vit për një ose dy javë, duke filluar nga 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave. Vendosja e një fjongoje të tillë është një zotim publik që kurrë të mos krëjmë, falim ose të qëndrojmë të heshtur në rastet e dhunës ndaj grave. Fjongoja vjollcë simbolizon një thirrje për të gjithë meshkujt që të ulin duart poshtë në luftën ndaj motrave tona.
- Ne u kërkojmë bashkimeve të ndryshme, shoqatave të profesionistëve, grupeve të studentëve, kompanive të ndryshme, institucioneve fetare, medias, organizatave qeveritare dhe atyre jo-qeveritare që ta bëjnë këtë çështje një prioritet të axhendave të tyre.
- Ne nxisim qeverinë që të aprovojë ligje të përshtatshme kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave, dhe të financojë

programe për të mbijetuarit e kësaj dhune, si strehëza për gratë e dhunuara dhe qendra për rastet e përdhunimeve, si dhe institucione që ofrojnë shërbime për meshkujt e dhunshëm.

- Ne bëjmë thirrje për programe edukative dhe ndërgjegjësimi, në shkallë të gjerë, në shkolla dhe vendet e punës, për punonjësit e policisë dhe gjykatësit, lidhur me çështjen e dhunës së ushtruar nga meshkujt.
- Ne besojmë se respekti për gratë e vajzat, si dhe barazia e drejtësia midis grave dhe burrave janë detërimisht të nevojshme për t'i dhënë fund dhunës.
- Ne nxisim meshkujt që të organizojnë fushata lokale dhe kombëtare kundër dhunës ndaj gruas, të cilat të jenë të hapura për të gjithë djemtë dhe burrat e të gjithë spektrave politikë, socialë dhe ekonomikë.

Kjo broshurë është përgatitur për të paraqitur rrjedhojat individuale dhe shoqërore të dhunës kundrejt fëmijëve dhe të rinjve dhe mënyrat se si ne të gjithë mund të ndihmojmë për të parandaluar këtë dukuri të shëmtuar të shoqërisë tonë. Disa shembuj janë sjellë për të paraqitur para syve tanë atë çka ne përjetojmë herë pas here në jetën e përditshme dhe nuk bëjmë asgjë për ta ndryshuar.

Me fuqi dhe dashuri, ne e angazhojmë veten tonë që të punojmë përkrah grave për t'i dhënë fund dhunës në familje.

Çfarë mund të bësh dhe ti për të ndaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave?

► *Dëgjoji gratë, mëso prej tyre*

Çdo gjë fillon me të dëgjuarit. Mendojmë se ne dimë më tepër për dhunën ndaj grave sesa vetë ato që e provojnë atë? Studimet thonë se në shumicën e vendeve, 50-100 për qind e grave kanë provuar dhunë fizike ose seksuale.

Mësoni për dhunën duke pyetur gra apo vajza që kanë besim tek ju, lidhur me faktin sesi ka ndikuar dhuna në jetët e tyre. Dhe atëherë, nëse ajo ndihet mirë që të bisedojë me ju, uluni dhe dëgjoni. Roli juaj nuk është që ta sfidoni deri në detaje, as të debatoni nëse gjëra specifike e kanë bezdisur apo jo. Duhet të jetë vetëm dëgjim. Thjesht besoni kur ajo thotë se diçka e ka lënduar ose jo.

► **Informohu rreth problemit**

Dhuna ndaj grave përfshin sulmet fizike dhe seksuale, ngacmimin seksual, abuzimin psikologjik, ose atë emocional. Jo të gjitha format e dhunës lënë shenja të dukshme. Dhuna emocionale përfshin bërjen subjekt të shakave të pakuptimta dhe fyerëse, forma të sjelljes dominante dhe ngacmimin seksual.

Disa forma të dhunës kanë një ndikim më të madh fizik dhe emocional sesa të tjerat. Por, të gjitha format e dhunës kontribuojnë në frikën e vërtetë dhe vuajtjen që përjetojnë gratë në shoqëritë tona. Të drejtat bazë që shumica e meshkujve gëzojnë – siguria në shtëpitë e tyre, aftësia për të lëvizur gjatë natës, një punë ku nuk ka ngacmime të ndryshme – janë një burim frike për gratë në pjesën më të madhe të botës.

Frika është më e madhe në vetë shtëpitë e grave. Një mit i zakonshëm është se dhuna në shumicën e rasteve kryhet nga të panjohur. Në fakt, gratë

janë më tepër të rrezikuara nga burrat apo meshkujt që njohin, si: bashkëshortët, të dashurit, baballarët, të afërmit, punëdhënësit dhe perkujdesësit.

Shumë meshkuj i duan dhe perkujdesen për gratë. Por, prapëseprapë ata vetë ende ushtrojnë dhunë në një numër të konsiderueshëm rastesh ndaj grave, që ata vetë thonë se i duan. Ndodh në të gjithë botën, në rradhët e të pasurve, të varfërve dhe klasës së mesme, si dhe përfshin burra të kombësive, besimeve fetare dhe racave të ndryshme.

► **Mëso se përse meshkujt janë kaq të dhunshëm**

Nuk është se meshkujt lindin të dhunshëm. Ata mësohen të jenë të tillë, nga familja, shoqëria, mjedisi që i rrethon. Kështu, ka patur dhe ka shoqëri me pak ose aspak dhunë. Studimet gjatë shekullit të kaluar kanë nxjerrë në pah se gjysma e shoqërive tribale të studiuara, kanë patur pak ose

aspak dhunë ndaj grave, fëmijëve ose ndaj vetë meshkujve. Për më tepër, edhe në ditët e sotme, në shumë vende, pjesa më e madhe e meshkujve nuk janë fizikisht të dhunshëm.

Dhuna është rezultat i mënyrës që meshkujt mësojnë për të shprehur mashkulloritetin e tyre në marrëdhëniet me femrat, fëmijët dhe meshkujt e tjerë. Shumë prej tyre mendojnë për pushtetin si një aftësi për të dominuar dhe kontrolluar njerëzit dhe botën rreth tyre. Kjo mënyrë të menduari e bën përdorimin e dhunës të pranueshëm nga shumë meshkuj.

Shumë nga aktet individuale të dhunës së meshkujve janë përpjekje patetike për të vendosur kontroll ndaj grave, fëmijëve ose ndaj meshkujve të tjerë. Në mënyrë paradoksale, shumë akte të dhunës nga ana e meshkujve janë një shenjë e dobësisë, pasigurisë dhe mungesës së vlerësimit për veten, të kombinuara me një kapacitet për dominim verbal ose fizik dhe një ndjenjë se ata duhet të

jenë superiorë dhe të kontrollojnë gjithçka.

Gratë nuk janë të imunizuara ndaj akteve të dhunës. Ato janë shprehur kundra problemit të dhunës ndaj fëmijëve, që kryhet si nga vetë gratë ashtu dhe nga burrat, megjithëse abuzimi seksual i fëmijëve kryhet vetëm nga burrat. Gratë, gjithashtu, mund të jenë të dhunshme ndaj burrave ose grave të tjera, por kjo është në përmasa shumë më të vogla sesa dhuna e ushtruar nga burrat.

Në shumë incidente të dhunës, burrat kanë konsumuar më parë alkool. Kjo ndodh ndoshta sepse alkooli i lë të lira ndjenjat, frikërat, zemërimin dhe pasiguritë që disa meshkuj, të shkëputur prej kohësh nga ndjenjat e tyre, nuk mund t'i përballojnë. Por, nuk është alkooli shkaktari i dhunës. Dhe as gjenet nuk shkaktojnë dhunë. Kohët e fundit, ka patur përpjekje nga disa burra që të dominojnë gratë, të rritur që të dominojnë fëmijët, burra që kërkojnë të dominojnë burra të tjerë ose grupe burrash.

Dhuna është një mënyrë për të arritur pushtet, privilegje dhe kontroll.

► **Vendos një fjongo vjollcë**

Ndryshimi do të ndodhë nëse secili prej nesh pranon përgjegjësinë personale që kjo do të ndodhë. Si meshkuj që kujdesemi për gratë në jetët tona, ne duhet të marrim përsipër përgjegjësinë e të ndihmuarit të grave, që ato të jetojnë një jetë pa frikë dhe dhunë.

Çdo vit, meshkujt në të gjithë botën vendosin një fjongo që nga 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Grave, deri në 10 Dhjetor, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Për shembull, në Kanada, fjongoja mbahet deri më 6 Janar, dita kur më 1989, në Montreal u masakruan 14 gra.

Mbajtja e një fjongoje është një premtim personal që ti të mos ushtrosh dhunë ndaj grave. Është

një premtim personal që të mos falim aktet e dhunës, të mos justifikojmë ata që e shkaktojnë dhunën dhe të mos mendojmë se “gratë e kërkojnë vetë dhe e meritojnë dhunën”.

Është një premtim për të mos qëndruar në heshtje. Është një premtim që të sfidojmë meshkujt që ndodhen rreth nesh, që ata të heqin dorë nga dhuna.

Vendosja e një fjongoje nxit diskutime, debate dhe një eksplorim të vetes tek të gjithë njerëzit, veçanërisht tek meshkujt. Fjongoja është një katalizator për diskutime. Është një katalizator për ndryshimin.

► **Kundërshtoj gjuhën seksiste dhe talljet që i degradojnë gratë**

Talljet, “shakatë” dhe gjuha seksiste krijojnë një klimë ku format e dhunës dhe abuzimit janë pranuar për një kohë të gjatë. Fjalët që degradojnë gratë, reflektojnë një shoqëri që

historikisht i ka vendosur gratë në një pozicion klasor dytësor. Duke reflektuar këtë realitet, të gjitha këto që sapo përmendëm, i vendosin gratë në “vendin e tyre” edhe pse nuk synohet të arrihet kjo.

Një nga gjërat më të vështira për meshkujt është të mësojnë të sfidojnë meshkujt e tjerë që përdorin një gjuhë seksiste. Të sfidohen meshkujt që nuk e prekin aq sa duhet dhunën ndaj grave. Të sfidohen ata meshkuj që përfshihen në dhunë.

► **Identifiko dhe kundërshto dhunën**

Ngacmimi seksual i referohet ngacmimeve të padëshiruara seksuale ose shenjave dhe sjelljeve të orientuara drejt seksualitetit, që nuk dëshirohen nga personi tjetër. Flirtimi dhe shakatë janë mëse të pranueshme nëse kryhen brenda një konsensusi të përbashkët dhe kërkohen nga të dy personat. Ndërsa ngacmimi seksual e

helmon ambjentin.

Ngacmimi ka të bëjë kryesisht me pabarazitë e pushtetit. I njëjti veprim që kryhet nga një grua nuk mund të bezdisë një mashkull për shkak se, në përgjithësi, shoqëria jonë nuk u ka dhënë femrave pushtet mbi meshkujt. Meshkujt mund të bashkohen me gratë për të kundërshtuar ngacmimin seksual, duke mbështetur përpjekjet e përbashkëta në vendin e punës dhe shkolla për të krijuar një ambient më të shëndetshëm dhe më produktiv.

► **Mbështet programet lokale të grave**

Në të gjithë botën, gratë e dedikuara ndaj kësaj çështjeje kanë krijuar shërbime mbështetëse për gratë që i kanë mbijetuar dhunës së shkaktuar nga burrat: shtëpi të sigurta për gratë e rrahura, qendra të krizave pas përdhunimit, shërbime këshilluese dhe klinika të ndihmës ligjore. Këto dhe organizata të tjera të grave meritojnë dhe mbështetjen e burrave dhe ndihmën tonë

financiare. Kjo është arsyeja pse ne nxisim të tilla fushata, si një mënyrë për të ndërgjegjësuar mbarë publikun si dhe për të ngritur fonde në mbështetjen e nismave të tilla.

► ***Mendo sesi sjellja jote do të kontribuojë në zgjidhjen e problemit***

Nëse ke qenë ndonjëherë i dhunshëm ndaj një gruaje apo vajze, nëse ke kryer ndonjë sulm seksual, nëse ke goditur, kërcënuar, dëmtuar apo ofenduar bashkëshorten ose të dashurën tënde, atëherë ti ke qenë dhe je pjesë e problemit.

Nëse kjo ka ndodhur shumë kohë më parë, prano që ke vepruar gabim dhe përmirësoji gjërat, nëse është e mundur. Por, nëse një sjellje e tillë ka shumë shanse që të vazhdojë edhe në të ardhmen, atëherë ti menjëherë duhet të kërkosh ndihmë për të gjetur rrënjët e problemit. ***Mos prit derisa të ndodhë përsëri! Të lutemi që të veprosh që sot!***

Shumë burra dhe djem asnjëherë nuk do të jenë të dhunshëm fizikisht apo seksualisht. Por, megjithatë, le të ekzaminojmë mënyrat sesi ne përpiqemi të kontrollojmë gratë dhe vajzat. A i dominojmë ne bisedat? A e ulim shpesh poshtë dinjitetin e tyre? A i kufizojmë ato nga aktivitetet?

Edhe pse nuk mund të kesh qenë ndonjëherë i dhunshëm, të gjithë burrat dhe djemtë duhet të marrin përsipër përgjegjësinë e dhënies fund të të gjitha formave të dhunës ndaj gruas.

► ***Puno në drejtim të zgjidhjeve afatgjata***

Dhënia fund e dhunës nga grave dhe vajzave nuk do të ndodhë brenda një nate. Zgjidhjet e vërteta janë ato afatgjata. Kjo, për shkak ***se dhuna e burrave dhe djemve ndaj grave dhe vajzave është e rrënjësuar në pabarazitë gjinore midis të dy palëve dhe në mënyrën se si ne mësojmë të bëhemi dhe të jemi burra.***

Ndryshimet ligjore për të luftuar këtë dhunë (të tilla si: ligjet kundër përdhunimit dhe rrahjes) janë shumë të rëndësishme. Organet e policisë dhe ato gjyqësore duhet të synojnë detyrime më të mëdha dhe zbatimin real të këtyre detyrimeve.

Por, sërish kjo nuk mjafton. *Le të punojmë së bashku për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet. Le të sfidojmë institucionet që përjetësojnë pabarazinë midis grave dhe burrave.*

Le të ndihmojmë burrat që të zhvishen nga parzmoret e tyre, që janë qëndrimet të cilat barazohet mashkulloriteti me pushtetin për të kontrolluar. Le të bëjmë ndryshime pozitive në marrëdhëniet tona me gratë, fëmijët dhe meshkujt e tjerë. Le të përfshijmë burrat në rolin e përkujdesësve për fëmijët dhe të rinjtë.

Ndryshimet në qëndrime, sjellje dhe institucione kuptohet që kanë nevojë për kohë. Kështu që ne duhet të shohim sesi të rrisim brezat e tjerë. Ne duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë, për

shembull, se të gjitha format e dhunës janë të papranueshme dhe që djemtë të bëhen burra, nuk kanë nevojë të dominojnë gratë, fëmijët apo burra të tjerë.

► **Përfshihu në përpjekjet edukative kundër dhunës ndaj gruas**

Kjo fushatë është më e madhja, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në mbarë botën për t'i dhënë fund dhunës që burrat u shkaktojnë grave.

Kjo është një fushatë që rrënjët e saj i ka tek vullnetarizmi. Për shkak se qëllimi i fushatës është që burrat të marrin përgjegjësinë e të punuarit në drejtim të dhënies fund të kësaj dhune, nevojitet që të vlerësohet kontributi i të gjithëve, jo vetëm i grave, por edhe ai i burrave.

Përveç organizimit të shpërndarjes së fjongove vjollcë (duke filluar nga 25 Nëntori deri në 10 Dhjetor), mbështetësit lokalë mund të organizojnë dhe veprimtari të tjera përgjatë

vitit. Në këtë prizëm, mund të komunitete apo me organizata e përmendim bisedat në shkolla, institucione të ndryshme.

Shtatë karakteristikat e dhunës mashkullore

“Për një moment i largova sytë nga pjesëmarrësit në seminar dhe jashtë, përmes dritareve të dhomës së vogël të konferencave, shikoja Himalajet, veriun e Katmandu-së. Isha atje, duke drejtuar një seminar, iniciativë e punës së pamatë që kishin filluar UNICEF dhe UNIFEM, që një vit më parë kishin bashkuar gra dhe burra nga e gjithë Azia Jugore për të diskutuar problemin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe, më e rëndësishmja, për të gjetur së bashku zgjidhjet për këtë problem.

Duke u kthyer tek gratë dhe burrat e grupit, ndjeva se kishte një atmosferë më tepër familjare sesa të ndryshme midis tyre: gratë po ndërmerinin ndryshime të mëdha – në disa raste duke rrezikuar jetët e tyre – për të luftuar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Burrat sapo kishin filluar të dëgjonin zërat e tyre anti-patriarkalë dhe të zbulonin mënyra si të punonin përkrah grave. Dhe ajo që në mënyrë të këndshme më habiti, ishte reagimi pozitiv ndaj një seri idesh që unë prezantova lidhur me dhunën e ushtruar nga burrat. Deri atëherë, nuk isha ende i sigurt nëse ato ishin të përshtatshme jo vetëm për realitetet e Amerikës Veriore dhe Jugore, por dhe Europës, të cilat janë vende me kultura, zakone e tradita të ndryshme.”

Michael Kaufman

1.Pushteti patriarkal

Veprimet individuale të dhunës së shkaktuar nga meshkujt, unë i përshkrova si pjesë e brendshme e ‘triadës së dhunës mashkullore’. Dhuna e burrave ndaj grave nuk është se ndodh në izolim, por është e lidhur me dhunën e burrave ndaj meshkujve të tjerë dhe brendësimin e dhunës, që do të thotë, *dhuna e një burri ndaj vetes së tij*.

Dhe në të vërtetë, shoqëritë e domimuara nga meshkujt nuk janë bazuar vetëm në hierarkinë e burrave ndaj grave, por edhe të disa meshkujve ndaj meshkujve të tjerë. Dhuna ose kërcënimi nga dhuna në rradhët e burrave, është një mekanizëm i përdorur që nga fëmijëria për të vendosur këtë hierarki goditjesh dhe grushtash. Një rezultat i kësaj është se burrat dhe djemtë e ‘brendësojnë’ dhunën – ose ndoshta, kërkesat e shoqërisë patriarkale nxisin instiktet biologjike që relativisht mund të jenë thjesht duke fjetur në brendësi. Përfundimi është se jo vetëm djemtë dhe burrat mësojnë të përdorin dhunën

në mënyrë përzgjedhëse, por gjithashtu, ashtu siç do të shohim më vonë, edhe e ridrejton masën e emocioneve drejt zemërimit. Zemërimi disa herë merr formën e dhunës së drejtuar ndaj vetes, ashtu si dhe është parë, për shembull përmbajtja e sjelljes abuzive ose vetë-shkatërruese.

Kjo triadë e dhunës mashkullore, ndodh brenda një ambjenti që ushqen dhunën: organizimi dhe kërkesat e një shoqërie patriarkale ose të dominuar nga meshkujt.

Ajo që i jep dhunës pamjen e një mënyre për të bërë biznes, ajo çfarë e ka natyralizuar atë si standarti de fakto në marrëdhëniet njerëzore, është mënyra sesi është artikuluar në ideologjitë dhe strukturat tona sociale. Në mënyrë të thjeshtë, grupet njerëzore krijojnë forma vetë-përjetësuese të organizimit social dhe ideologji që shpjegojnë, u japin kuptim, justifikojnë dhe plotësojnë këto realitete të krijuara.

Dhuna, gjithashtu, është ndërtuar mbi këto ideologji dhe struktura, për arsye të thjeshtë sepse ka sjellë

përfitime të jashtëzakonshme për grupe të veçanta: së pari dhe më kryesorja, dhuna ka kontribuar në privilegjin e pajisjen e burrave me pushtet. Nëse në të vërtetë format origjinale të hierarkisë dhe pushtetit social janë ato të bazuara në seks, atëherë shumë kohë më përpara kjo krijoi një shabllon për të gjitha format e strukturuara të pushtetit dhe privilegjeve që shijohen nga të tjerët, si rezultat i klasës sociale ose ngjyrës së lëkurës, moshës, fesë, orientimit seksual ose aftësive fizike. Në një kontekst të tillë, dhuna ose rreziku i saj, bëhet një mjet për siguruar vazhdimësinë e privilegjeve dhe ushtrimin e pushtetit. Është si rezultat, ashtu dhe mjet në të njëjtën kohë.

2. Meritimi i privilegjit

Përvoja individuale e një burri që ushtron dhunë, nuk sillet rreth dëshirës së tij për të ruajtur pushtetin. Përvoja e tij e ndërgjegjshme nuk është se përbën çelësin kryesor në këtë rast. Nëse një burrë rreh bashkëshorten e tij, sepse darka nuk është gati

në tavolinë në kohën e duhur, kjo nuk bëhet vetëm për të bërë të qartë që kjo të mos përsëritet më, por është dhe një tregues i ndjenjës së tij të të merituarit të këtij qëndrimi. Ose, nëse një djalë sulmon seksualisht të dashurën e tij në një takim, ka të bëjë me ndjenjën e tij të të merituarit të kënaqësisë fizike, edhe pse kjo kënaqësi është krejtësisht e njëanshme. Me fjalë të tjera, ashtu siç kanë shprehur shumë gra, nuk janë vetëm pabarazitë e pushtetit që çojnë në dhunë, por shpesh dhe një ndjenjë e ndërgjegjshme ose e pandërgjegjshme e të merituarit të privilegjeve.

3. Pranimi

Çfarëdo të jenë shkaqet komplekse sociale dhe psikologjike të dhunës së meshkujve, ajo nuk do të mund të vazhdonte pa lejen e dukshme ose të nënkuptuar të rregullave socialë, kodeve ligjore apo vetë ligjeve. Në shumë vende, ligjet kundër dhunës ndaj grave apo sulmeve seksuale janë të dobëta ose nuk ekzistojnë. Në shumë të tjera ligjet ekzistojnë, por

zbatohen shumë pak. Në vende të tjera ato janë krejt absurde, si për shembull në ato vende kur akuza për përdhunim mund të provohet vetëm nëse ka disa dëshmitarë burra dhe ku dëshmia e një gruaje nuk merret si e vlefshme.

Në të njëjtën kohë, aktet e dhunës mashkullore dhe agresioni i dhunshëm (në këtë rast, kryesisht nga meshkuj të tjerë) përgëzohen në sporte dhe në kinematografi, në letërsi dhe në betejat luftarake. Jo vetëm që dhuna lejohet, por disa herë asaj i vishen elemente madhështie, lavdie apo shpërblehet. Një nga rrënjët historike të shoqërive patriarkale është dhe përdorimi i dhunës si një mjet për zgjidhur konfliktet, si midis individëve, ashtu dhe midis grupeve të meshkujve, ose dhe midis shteteve dhe kombeve.

Shpesh, kjo leje na vjen mendje kur dëgjojmë për një grua apo burrë që nuk thërrasin policinë kur dëgjojnë se një grua apo fëmijë tjetër po dhunohet fizikisht. Mendohet gjithmonë si një çështje 'private'. *A mund të*

imagjinoni dikë që po bën sehir ndërsa sheh se një apartament po vidhet dhe ai nuk thërret policinë, sepse mendon se është një çështje private mes vjedhësit dhe të zotit?!

4. Paradoksi i pushtetit të burrit

Këtu ne duhet të merremi me paradokset e pushtetit të meshkujve ose asaj që ndryshe quhen 'përvojat kontradiktore të pushtetit mashkullor'.

Mënyrat më të përdorura nga burrat për të ndërtuar pushtetin social dhe individual janë, në mënyrë paradoksale, burimi i një frike të madhe, izolimit dhe dhembjes për vetë meshkujt. Nëse pushteti është ndërtuar si një kapacitet për të dominuar dhe kontrolluar; nëse kapaciteti për të vepruar në mënyra 'të pushtetshme' kërkon ndërtimin e një kostumi mbrojtës personal dhe vendosjen e një distance frike nga të tjerët; nëse bota e vërtetë e pushtetit dhe privilegjit na çon larg nga bota e rritjes dhe

përkujdesjes për fëmijët, atëherë ne po krijojmë burra, përvoja e të cilëve është plotësisht e mbushur me probleme.

Kjo vjen veçanërisht, për shkak se pritshmëritë e brendësuar të mashkulloritit, janë të pamundura për ta që të plotësohen apo mbahen. Ky mund të jetë edhe një problem i pandarë i patriarkalitetit, por duket mëse i vërtetë në një erë apo në kultura ku kufijtë e ashpër gjinorë janë prishur e rrëzuar. Pavarësisht nëse është një arritje fizike apo financiare, nëse është shtypja e emocioneve dhe nevojave njerëzore, thelbi i mashkulloritit (ndryshe nga siguritë e thjeshta biologjike të mashkullores), duket se kërkon një vigjilencë dhe punë të vazhdueshme, veçanërisht për djemtë e rinj.

Pasiguritë personale që kanë të bëjnë me dështimin për të arritur mashkulloritetin e vërtetë, ose thjesht frika nga dështimi, është e mjaftueshme që t'i vendosë shumë burra, veçanërisht kur janë të rinj, në një rreth frike, izolimi,

vetë-ndëshkimi, vetë-urrejtjeje dhe agresioni.

Brenda një gjendjeje të tillë emocionale, dhuna bëhet një mekanizëm kompesues. Është një mënyrë për të rivendosur ekuilibrin mashkullor, duke i ridhënë vetes kredencialet e nevojshme mashkullore. Kjo shprehje e dhunës, zakonisht përfshin dhe zgjedhjen e një shënjestre që është fizikisht më i/e dobët dhe më tepër i/e rrezikuar. Kjo shënjestër mund të jetë një fëmijë, grua ose mund të jetë një grup social, të tillë si një minorancë fetare ose sociale, ose emigrantët, të cilët duket se janë një shënjestër e lehtë për pasigurinë ose zemërimin e individëve meshkuj, veçanërisht nëse këtyre grupeve nuk u është siguruar një mbështetje dhe mbrojtje e përshtatshme ligjore.

Çfarë e ka lejuar dhunën të shërbejë si një mekanizëm individual kompesimi, ka qenë pranueshmëria e gjerë e dhunës si një mjet për zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e

pushtetit dhe kontrollit. Çfarë e bën të mundur, është pushteti si dhe privilegjet që burrat kanë shijuar, gjërat që janë kthyer në besime të patundshme, praktikat, strukturat sociale dhe ligji.

5. Parzmorja psikike e burrërisë

Dhuna e meshkujve është gjithashtu dhe rezultat i strukturës së karakterit të bazuar në distancën emocionale nga të tjerët. Shumë studiues kanë sugjeruar se strukturat psikike të burrërisë janë krijuar në ambjentet e hershme të rritjes së fëmijëve, që shpesh kanë vuajtur nga mungesa e babait ose e meshkujve të tjerë të rritur – ose të paktën, nga mungesa e distancës emocionale mashkullore. Në këtë rast, mashkulloriteti kodifikohet nga mungesa e këtyre përvojave dhe ndërtohet vetëm në nivelin e fantazisë.

Por, edhe në kulturat patriarkale, ku baballarët janë më tepër të pranishëm, mashkulloriteti është kodifikuar si një refuzim i nënës dhe feminitetit, që është, refuzimi

i cilësive që janë të lidhura me përkujdesjen. Ashtu siç kanë shprehur dhe psikoanalistë të ndryshëm feministë, kjo krijon një pengesë të ashpër për ego-n, ose në terma metaforikë, *një parzmore të fortë mbrojtëse*.

Rezultati i këtij procesi kompleks dhe të veçantë të zhvillimit psikologjik, është një aftësi e mefshtë, e dobët për empati (të përjetosh atë që ndiejnë të tjerët) dhe një paaftësi për të përjetuar nevojat dhe ndjenjat e njerëzve të tjerë, duke menduar se ato u përkasin vetëm personit që i përjeton. Aktet e dhunës kundër një personi tjetër, sipas këtij argumenti, janë të mundshme. Sa shpesh dëgjojmë një burrë që thotë se ‘nuk e dëmtova’ gruan që ai godet apo rreh? Po shpesh themi dhe që ai po justifikohet, por pjesë e problemit është se ai në të vërtetë nuk e përjeton dhimbjen që po shkakton.

6. Shtypja e ndjenjave

Shumë nga format dominante të mashkulloritetit janë gjithmonë

të lidhura, si mentesha me derën, me brendësimin e shkallës së emocioneve dhe ridrejtimin të tyre në zemërim. Nuk ka të bëjë thjesht me atë që gjuha e emocioneve të meshkujve është shpesh memece ose që antenat e tyre emocionale dhe kapaciteti për empati janë disi jashtë funksionit, apo janë dobësuar. Është gjithashtu dhe masa e emocioneve natyrale që janë paracaktuar përtej kapaciteteve të mundshme, dhe kësisoj, janë të pavlefshme në realitet.

Ndërkohë që kjo ka një specifikë kulturore, është më tepër tipike për djemtë që të mësojnë një moshë më të hershme të shtypin ndjenjat e frikës dhe të dhimbjes. Në fushat e sportit, ne i mësojmë djemtë që të injorojnë dhembjen. Në shtëpi ne u themi djemve të mos qajnë dhe 'të sillen si burra'. Disa kultura nxisin një burrëri stoike. Dhe duhet theksuar se: djemtë i mësojnë gjëra të tilla për të mbijetuar. Megjithatë, është e rëndësishme të thuhet që ne nuk fajësojmë djalin apo burrin individ për origjinat e sjelljes së tij aktuale, edhe pse, në të njëjtën

kohë, ne e bëjmë atë përgjegjës për veprimet e tij.

Sigurisht, si qenie njerëzore, ne ende përjetojmë ngjarjet që shkaktjnë një reagim emocional. Por, mekanizmat e zakonshëm të reagimit emocional, nga përjetimi aktual i një emocioni deri tek lëshimi i një ndjenje, kanë një qark të shkurtër dhe ndodhin në një shkallë të ndryshme në rradhët e meshkujve. Por, përsëri për shumë burra, emocioni që ka një lloj vlere është zemërimi. Rezultati është se e gjithë masa e emocioneve kanalizohet në drejtim të zemërimit. Ndërkohë që ky lloj kanalizimi nuk është unik tek burrat (por dhe nuk është i vlefshëm për të gjithë burrat), për disa prej tyre, reagimet e dhunshme ndaj frikës, lëndimit, pasigurisë, dhimbjes, refuzimit apo injorimit nuk janë të pazakonta.

Kjo është veçanërisht e vërtetë kur ndjenja që prodhohet është ajo e të mos paturit pushtet. Një ndjenjë e tillë vetëm sa i zmadhon pasiguritë mashkullore: nëse burrëria ka të bëjë me

pushtetin dhe kontrollin, të qenit i pafuqishëm do të thotë që nuk je burrë. Përsëri, dhuna bëhet një mjet për t'i provuar të kundërtën vetes dhe të tjerëve.

7. Përvojat e kaluara

Një numër i konsiderueshëm meshkujsh në të gjithë botën janë rritur në shtëpi ku nënat e tyre janë dhunuar nga baballarët. Ata rriten duke e parë sjelljen e dhunshme ndaj grave si një normë, ashtu si dhe një mënyrë sesi jetohet jeta. Për disa meshkuj, kjo rezulton në një kthim në drejtim të dhunës, ndërkohë që për të tjerë prodhon një reagim të mësuar. Në shumë raste ndodhin të dyja: meshkujt që përdorin dhunën ndaj femrave shpesh ndjejnë një urrejtje të thellë për veten dhe sjelljet e tyre.

Por fraza 'reagim i mësuar' është shumë e thjeshtëzuar. Studimet kanë treguar se djemtë dhe vajzat që rriten duke qenë dëshmitarë të dhunës, janë më tepër të prirur që të jenë dhe vetë të dhunshëm. Kjo dhunë mund të jetë një mënyrë për të tërhequr vëmendje; mund

të jetë një mekanizëm kopjimi, një mënyrë për të zhvendosur jashtë vetes pamundësinë për të kuptuar dhe vlerësuar ndjenjat. Këto modele të sjelljes vazhdojnë edhe përtej fëmijërisë: shumë meshkuj që përfundojnë në sjellje të dhunshme, kanë qenë dëshmitarë të abuzimit ndaj nësës së tyre ose kanë përjetuar vetë abuzim.

Përvojat e kaluara të shumë meshkujve përfshijnë edhe dhunën që ata vetë kanë përjetuar. Në shumë kultura, ndërkohë që djemtë janë dy herë më pak të prirur që të përjetojnë abuzim seksual krahasuar me vajzat, ata janë dy herë më tepër të prirur që të përjetojnë abuzim fizik. Përsëri, kjo nuk prodhon ndonjë rezultat fiks dhe nga ana tjetër, këto rezultate nuk janë unike për të gjithë djemtë. Por, në disa raste këto përvoja personale i rrënjosin thellë modelet e konfuzionit dhe frustracionit, ku djemtë kanë mësuar se është e mundur të lëndosh dikë që dashuron, ku vetëm shpërthimet e pamata të zemërimit mund të të çlirojnë nga

ndjenjat e thella të dhembjes.

Dhe së fundmi, ka një mbretëri të tërë të një dhune të papërfillshme midis djemve e cila, nga pozicioni i një djali, nuk duket fare e papërfillshme. Djemtë, në shumë

kultura, rriten me eksperiencat e të luftuarit, krekosjes dhe brutalitetit. Mbijetesa absolute kërkon, për disa, pranimin dhe brendësimin e dhunës si një normë të sjelljes.

Dhënia fund e dhunës

Kjo analizë, edhe pse e paraqitur në një formë kaq të përmbledhur, sugjeron se sfidimi i dhunës mashkullore kërkon një reagim të artikulluar që përfshin:

- Sfidimin dhe prishjen e strukturave të pushtetit dhe privilegjeve të meshkujve, si dhe dhënien fund të pranimet kulturor dhe social për aktet e dhunës. Nëse ky është momenti kur dhuna fillon, ne nuk mund t'i japim fund pa mbështetjen e grave dhe burrave për feminizmin dhe reformat e transformimet sociale, politike, ligjore dhe kulturore që kjo filozofi sugjeron.
- Ripërkufizimin e mashkullori-

tetit ose, në të vërtetë, prishjen e strukturave psikike dhe sociale të përkatësisë gjinore që ato sjellin me vete, siç është rreziku nga dhuna. Paradoksi i patriarkalitetit është dhimbja, zemërimi, frustrimi, izolimi dhe frika në rradhët e gjysmës së specieve, për të cilët relativisht pushteti dhe privilegjet janë diçka e dhënë dhe e merituar. Ne i injorojmë të gjitha këto. Me qëllim që të arrijë tek burrat në mënyrë të suksesshme, kjo punë duhet të kryhet me përkushtim, dashuri dhe respekt, e kombinuar me një sfidë të qartë të normave negative mashkullore dhe rezultateve

- të tyre shkatërruese.
- Organizimi dhe përfshirja e burrave në një punë bashkëpunuese me gratë për të riformëzuar organizimin gjinor të shoqërisë, në veçanti, institucionet dhe marrëdhëniet tona përmes të cilave ne rrisim dhe socializojmë fëmijët. Kjo kërkon më tepër vëmendje në rëndësinë e meshkujve si përkujdesës dhe rritës të fëmijëve, pra duke i përfshirë ata plotësisht në rritjen e fëmijëve me mënyra pozitive dhe që e shmangin përdorimin e dhunës.
 - Puna dhe përpjekjet e vazhdueshme me meshkujt që ushtrojnë dhunë në mënyrë që në të njëjtën kohë të sfidohen pranimet e tyre patriarkale për privilegjet që ata duhet të gëzojnë në shoqëri. Ne nuk duhet të përgëzojmë atë që ata kanë bërë, por as të ndihemi të tmerruar nga faktorët që e kanë çuar një djalë në procesin e tij të rritjes, për të qenë një burrë që kryen gjëra të tmerrshme. Përmes një respekti të tillë, këta meshkuj do mundën të gjejnë hapësirën për të sfiduar veten e tyre dhe të tjerët përreth. Përndryshe përpjekja për të arritur tek ta, do të ushqejë më tepër pasigurinë e tyre si meshkuj, dhe do t'i drejtojë më tepër tek dhuna si kompesimi i tyre tradicional.
 - Aktivitete të qarta edukative, të tilla si kjo fushatë, që përfshin burra dhe djem që sfidojnë veten dhe burrat e tjerë për t'i dhënë fund të gjitha formave të dhunës. Kjo është një sfidë pozitive për burrat, që mund të flasin me dashuri dhe përkushtim për gratë, djemtë, vajzat dhe burrat e tjerë.

A e dije ti këtë?¹

- Për gratë e moshës 15-44 vjeç, dhuna në familje është shkaku kryesor i dëmtimit dhe plagosjes, më shumë se aksidentet rrugore, sulmet apo vdekjet nga kanceri.
- 40 për qind e vajzave 14- 17 vjeçare tregojnë se një bashkëmoshatare e tyre është dhunuar nga partneri i saj.
- Dhuna në familje rrezikon të trashëgohet tek dëshmitarët e saj. Fëmija dëshmitar i dhunës që ushtron babai ndaj nënës së tij, rrezikon 3 herë më shumë të sillet njësoj në moshë të rritur.
- Në SH.B.A burrat kryejnë 13.000 akte të dhunshme në vit ndaj grave në vendin e punës.
- Dhuna në familje i kushton vendit 5 deri 10 bilionë dollarë çdo vit, për shpenzimet mjekësore, kostot për policinë dhe gjykatat, strehëzat, sistemin e përkujdesjes shëndetësore, etj.

A mjaftojnë të gjitha këto për të t'i dhënë fund dhunës në familje?

Atëherë, bashkohu dhe ti në mesazhin e kësaj fushate:

***Duart nuk janë për të qëlluar,
fjalët nuk janë për të fyer!***

¹ http://www.harborcov.org/pages/domestic_violence/index.asp - Vizituar për herë të fundit më 9 Nëntor 2005.

Kontakte të nevojshme:

Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza “Mos hesht!”

Rr. “Pjetër Bogdani”, P. 39/1 Ap 6/1
Kutia Postare 2416/1, Tiranë
Tel: 04 233 408
E-mail: qkgv@albnet.net

Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara

Tel: 04 233 408
Tiranë

Qendra e Këshillimit, Pogradec

Rr. “Reshit Çollaku”
Tel: 083 22 140

Unë, Gruaja

Rr. “Reshit Çollaku”
Pogradec
Tel. & Fax: 0832 5104

Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Durrës

Rr. “Skënderbej”, Lagjia 3, pranë shkollës “Jan Kukuzeli”
Tel. & Fax: 052 24 962
E-mail: bceveli@yahoo.com

Qendra e Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Shkodër

Rr. “13 Dhjetori”
Tel. 022 42 213
E-mail: qkgv@albnet.net

Gruaja tek Gruaja

Rr. “Marin Barleti” sipër Kristalit
Tel. 022 41154 (fax)
Shkodër
E-mail: gtg@adanet.com.al

Forumi i Gruas, Elbasan

Lagjia “Aqif Pasha”, Rr. “28 Nëntori”. P. 77/5
Tel: 054 54 516
E-mail: ccawgel@enet.org.al

Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Berat

Pallati i Kulturës
Tel: 032 31 004
E-mail: qkgvberat@yahoo.com

Shoqata “Refleksione”

Rr. Elbasanit, P. “Fratari”, Tershan 2,
Kati I
Tiranë
Tel: 04 340 433
Fax: 04 340 432
E-mail: refleksione@albnet.net;
refleksione@icc-al.org
Faqja e internetit: www.refleksioneassoc.org/

**Qendra për Nisma Ligjore
Qytetare (Ish-Qendra Avokatore
e Gruas)**

Rr. "Vaso Pasha", P. 12, Shk. 1.
Ap. 1
Tiranë
Tel: 04 259 795
Tel. & Fax: 04 241 419
E-mail: avokatore@albmail.com
Faqja e internetit: www.qag-al.org

**Qendra e Trajtimit
MultiDisiplinor për Problemet e
Keqtrajtimit të Fëmijëve**

Rr. "Pjetër Bogdani"
P. Teuta, Kati 3/4
Tel: 04 267 038
04 230 820
E-mail: chabuse@albaniaonline.net

**Qendra për Mbrojtjen e të
Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
-CRCA**

Pallatet e Shallvareve, Vila mbrapa
fushave te Tenisit, Kati 3
Kutia Postare Nr. 1738, Tiranë
Tel / Fax: 04 242264
E-mail: crca@crca.org.al

Faqja e internetit: www.crca.org.al

**Kryqi i Kuq Shqiptar (Zyra
Qendrore)**

P.O. BOX 1511
Tiranë
04 225855

**Kryqi i Kuq Spanjoll (Zyra
Qendrore)**

Rr. "Budi" P. Classic Construction
Tiranë
Tel. 04 378380

**Qendra e Aleancës Gjimore për
Zhvillim (Ish-Qendra e Gruas)**

Rr. "Abdyl Frashëri" P. 10 Shk.1. Ap. 3
Kutia Postare 2418
Tel: 04 255 514/5
Te. & Fax: 04 255 515
E-mail: info@women-center.tirana.al
Faqja e internetit: www.women-center.org.al

Referencat

- Kaufman, Michael: “The 7 P’s of Men’s Violence”. Toronto, Kanada - Tetor 1999.
- <http://www.michaelkaufman.com/articles/index.html> - Vizituar për herë të fundit: 3 Nëntor 2005.
- http://www.harborcov.org/pages/domestic_violence/index.asp - Vizituar për herë të fundit më 9 Nëntor 2005.
- www.whiteribbon.com - Vizituar për herë të fundit: 3 Nëntor 2005.